

V E N D I M
Nr. 114, datë 31.3.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.429, DATË 25.3.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KOHËN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË SISTEMIN E
SHËNDETËSISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 81, 87 dhe 91 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.429, datë 25.3.1966 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në orën 22.00 paguhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 81 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"."

2. Pika 6 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Puna e kryer ditën e dielë ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 87 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"."

3. Pika 7 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Për orët suplementare të punës, që nuk janë kompensuar me pushim, punëmarrësit i jepet paga normale dhe një shtesë mbi pagë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 91 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko